



RAPORT VJETOR 2021



NOA

INSTITUCION FINANCIAR





PËRMBAJTJA

NOA, NJË INSTITUCION FINANCIAR ME IMPAKT	6
VITI 2021 : AKSESI NË FINANCË SI NJË GARANCI PËR RIMËKËMBJEN	8
NJË FINANCIM PËR ÇDO BIZNES, FERMER, APO FAMILJE	11
BIZNESI I VOGËL	12
FAMILJET & INDIVIDËT	14
NJË HAP PËRPARA DREJT TRANZICIONIT TEKNOLOGJIK	16
KREDITIM & KËSHILLIM: NJË FORMULË NË SHËRBIM TË RIMËKËMBJES	18
KOMUNIKIMI, NXITËS I NJË IMPAKTI SOCIAL MË EFEKTIV	20
EKSPERIENCA E KLIENTIT, NJË INVESTIM I VAZHDUESHËM NË PËRMIRËSIM	22
NJË PASQYRË RISISH	25
SIGURIA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE, BESUESHMËRISË DHE FLEKSIBILITETIT TË SISTEMEVE IT	26
NDËRVEPRIMI DHE PËRMIRËSIMI I PROÇESEVE	27
PRAKTIKAT MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE, JANË DHE LOKALE	28
NJË INSTITUCION NË TERREN, KU(R)DO	30
NJË MBËSHTETJE FINANCIARE ME RISK TË KONTROLLUAR	33
CILËSIA E PORTOFOLIT	34
BURIMET NJERËZORE, VLERA E VERTETË E NJË KOMPANIE	36
AUDIT REPORT	41
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	45

NOA, NJË INSTITUCION FINANCIAR ME IMPAKT

Viti 2021, viti i parë pas pandemisë nuk ishte më pak sfidues sesa viti paraardhës, përkundrazi. Përshtatja me një mënyrë të re jetese dhe pamundësia për të ndërtuar plane afatgjata, ndikuan në mënyrë masive sjelljen konsumatore, por edhe ciklin e biznesit në planet respektive. Dëshira për rimëkëmbje dhe për të lënë pas ngjarjet e zymta të vitit 2020 ishte e madhe, por edhe pasiguria për të ardhmen gjithashtu, duke e bërë më të brishtë komunikimin dhe ndërveprimin njerëzor. Prandaj sfida më e madhe përgjatë 2021 si Drejtues ishte krijimi i një vizioni të qartë për të ardhmen e Institucionit por edhe të çdo individi brënda tij, përcjellja e sigurisë dhe përkrahjes, mirëkuptimit dhe frymës pozitive, që me krenari mund të them mbizotëroi në të gjithë periudhën.

Slogani ynë kryesor #kuRdo ishte shumë domethënës dhe njerëzor – jemi pranë jush, kudo që të keni nevojë dhe në çdo kohë, për t'ju mbështetur në planet apo nevojat tuaja të biznesit, të fermës apo familjes me të gjithë gamën e shërbimeve tona. Një mesazh me shumë kuptim për klientët, por edhe shumë frymëzues për stafin tonë, duke qënë një sjellje ndryshe nga shumë institucione të tjera financiare, në një periudhë shumë kritike dhe të pasigurtë. Të gjithë së bashku, ne zgjodhëm të vazhdonim të financonim ekonominë shqiptare, të mbështesim klientët tanë edhe më fort se vitet e tjera, sepse besuam se ishte momenti kur nevoja ishte më e madhe.

Kredia e re e dhënë gjatë vitit 2021 u rrit me 30% krahasimisht me një vit më parë, duke afruar pranë kompanisë sonë rreth 5,000 klientë të rinj, të cilët u shërbyen jo vetëm me cilësi të lartë, por edhe me shpejtësinë e duhur në funksion të nevojave të biznesit. 85% e kredive të dhëna gjatë vitit, janë lëvruar tek klienti brënda 24 orëve, pavarësisht nëse i jepej një biznesi apo fermeri. Puna e stafit tonë në terren e kombinuar me automatizimin total të procesit të kredidhënies, mundëson shpejtësi dhe siguri në kredidhënie. Portofoli i kredisë u rrit me 13% gjatë vitit, shifër kjo shumë domethënëse e kombinuar me cilësinë shumë të mirë të tij. Portofoli me probleme, mbi 90 ditë vonesë, rezultoi në nivelin 2.2%, ndërsa portofoli mbi 30 ditë në vonesë në nivelin 3.5%, dy indikatorë të mbajtur në nivele stabël prej vitesh tashmë.

Gjatë këtij viti, përveç kontributit të lartë në kredidhënie, fokus të shtuar kanë patur aktivitetet e këshillimit, në fushat e bujqësisë, pemtarisë, blegtorisë si dhe tregtisë. Ekspertë të fushës, të angazhuar prej nesh, punuan me ritme të shpejta së bashku me stafin tonë, për të ndërtuar udhëzues të ndryshëm që u erdhën në ndihmë klientëve tanë gjatë ciklit të biznesit. E në momente të tilla, të vështira ekonomike, këshillimi bëhet shumë i rëndësishëm për klientët, përtej financimit, për të siguruar një ecuri të qëndrueshme të biznesit të tyre në të ardhmen.

Mikrofinanca tradicionale duket si një realitet i tejkaluar, teksa impakti në ambjentin ekonomik, social dhe teknologjik ku operojnë klientët tanë kthehet në fokusin madhor të çdo institucioni. E tashmja është shumë e ndryshme dhe më sfiduese sesa e shkuara, e ardhmja do të vazhdojë t'i shumëfishojë këto sfida kur shohim çfarë peshe aspak të neglizhueshme merr mikro-ekonomia në atë kombëtare. Kështu që ne, në NOA, së bashku me klientët tanë po përgatitemi për këtë, duke e ndërtuar të ardhmen së bashku, përgjatë këtij rrugëtimi këshillues – financiar shumëvjeçar.

Vërtet, duke e menduar, 2021 ishte një vit që vazhdoi me sfidat e vitit paraardhës, por ne ja kemi dalë mbanë duke ja besuar marrëdhënien me klientët, njerëzve tanë, skuadrës sonë që vazhdon të rritet në numër dhe profesionalisht, jemi falenderues çdo stafi për vlerat, përgjegjshmërinë dhe pasionin e treguar çdo ditë të këtij viti, falë tyre vazhdojmë të ndërtojmë marrëdhënie të ngushta me klientë dhe partnerë, falë tyre e kemi të mundur të ndërtojmë plane ambicioze në të ardhmen dhe të krenohemi me impaktin që kemi dhënë, po japim dhe do të japim më tej në zhvillimin e sipërmarrjes vendase dhe ekonomisë lokale.



Herjola Spahiu
CEO

VITI 2021 : AKSESI NË FINANCË, NJË GARANCI PËR RIMËKËMBJEN

Secili prej dymbëdhjetë muajve të vitit 2021, ishte i mbushur me sfida e të papritura për shkak të klimës post-pandemi e cila vazhdoi të mbizotëronte edhe pas pikut të vitit të shkuar. Pavarësisht këtij realiteti të panjohur, besnike e misionit themelues prej vitit 1998, NOA u diferencua në tregun financiar shqiptar duke siguruar përgjatë gjithë vitit 2021 një akses të vazhdueshëm në financime për të gjithë sipërmarrësit e vegjël, fermerët e familjet ...


Duke injektuar në ekonominë shqiptare mbi 36 milion euro, për mbi 10.700 mikro-kredi të disbursuara anembanë vendit, NOA mbështeti gjatë vitit 2021 qindra e mijëra iniciativa private drejt rimëkëmbjes së aktivitetit ekonomik.

Kjo është mikrofinanca dhe ky është misioni kryesor i një institucioni financiar lider në garantimin e një aksesit të thjeshtëzuar në financim, pavarësisht krizës, situatës apo

kushteve të tregut. Kjo është mënyra sesi ne kontribuojmë në mbrojtjen e vendeve të punës, në zgjerimin e linjave të prodhimit, në rinovimin e bizneseve, dhe në garantimin se mikro-ekonomia e sipërmarrjeve familjare në Shqipëri nuk do të ndalet kurrë së prodhuari.

Nga financimet përgjatë vitit 2021, mbi 5.800 ishin klientë ekzistues të NOA-s ç'ka konfirmon jo vetëm rëndësinë e kreditimit në mbarëvajtjen normale të aktivitetit ekonomik në një kontekst post-krizë, por edhe lidhjen cilësore që ekziston mes klientëve dhe Institucionit. Garantimi i një shërbimi cilësor, transparent, të kudo & kurdo-gjendur, janë të gjitha të nevojshme për çdo marrëdhënie besimi afatgjatë. Dhe është pikërisht ndërtimi i një marrëdhënie të tillë, mes stafit dhe klientëve tanë, që viti 2021 u bë i mundur të ishte një vit plotësisht i arrirë në objektivin tonë në shërbim të ekonomisë shqiptare.

Ecuria e Portofolit të Kredisë ndër vite



10,723

Numri i kredive të disbursuara



4,435 Miliard Lekë


Volumi i kredisë së disbursuar



13%


Rritja e portofolit

Disbursimet sipas segmenteve



Individë Agrobiznes Biznesi i vogël

Disbursimet sipas zonës gjeografike



Rural Urban



NJË FINANCIM PËR ÇDO BIZNES, FERMER, APO FAMILJE

Agrobiznesi ka qënë dhe vijon të jetë një nga prioritet institucionale në NOA edhe për vitin 2021, duke përfaqësuar 22% të total portofolit të institucionit. Pavarësisht vështirësive të krijuara nga situata pandemike, ky segment pati një zhvillim tepër pozitiv i cili filloi në pjesën e dytë të 2020 edhe vazhdoi bindshëm në 2021, duke u rritur me 11%, ose rreth 136 Milion Lekë nga viti i mëparshëm. Pavarësisht sfidave të përhershme që shoqërojnë sektorin, si paqëndrueshmëria e theksuar në çmimet e produkteve, rritja e kostove të shërbimeve në fermë etj, ne kemi zgjedhur të mbështesim në të gjitha fazat e zhvillimit edhe të kemi sot një portofol tepër cilësor, me klientelë afatgjatë, me disa cikle financimi. Rreth 700 klient të rinj në këtë sektor i janë bashkuar kompanisë përgjatë vitit 2021.

Përpos financimit të agrobiznesit, një fokus të veçantë ka marrë dhe "këshillimi profesional", një element ky për të cilin sektori ka tepër nevojë. Përgjatë vitit kemi realizuar një sërë aktiviteteve me natyrë këshilluese, në çdo rajon, për të qënë sa më pranë fermerëve në sfidat dhe nevojat e tyre.

Si NOA jemi investuar në krijimin e një hapësire të dedikuar për fermerët në website tonë, në të cilën mund të aksesojnë informacion të nevojshëm këshillues, në kohën e duhur të gjithë fermerët për zhvillimet në gjithë zinxhirin e vlerës.

Ne vlerësojmë se ky sektor mbetet një nga më të rëndësishmit në vend dhe do të vazhdojmë të jemi katalizatori e ndërmjetësi kryesor financiar për të mbështetur në çdo kohë zhvillimin e Agrobiznesit në vend.

BIZNESI I VOGËL

Viti 2021 njohu një rritje portofoli me 14% ose 448 Milion Lekë, një rritje kjo e konsiderueshme krahasuar me një vit më parë. Kontribuesi kryesor në këtë arritje ishte bashkëpunimi dhe puna në grup e të gjithë skuadrës së biznesit dhe të gjithë stafit tonë në terren.

Duke vlerësuar të gjithë rreziqet, pasiguritë e dy viteve të fundit, të cilët ndikuan në një frenim të investimeve në vend, sërish arritëm të financonim klientë të rinj për institucionin, ndonëse përballë një situatë të tillë, me shumë të panjohura, fokusi kryesor institucional ishte shërbimi dhe këshillimi i duhur për klientët besnikë.

Me rikthimin e një situatë gjithmonë e më pranë normales, në gjysmën e dytë të vitit, bizneset në pjesën më të madhe të sektorëve në vend duket se iu rikthyen ritmit të investimeve dhe zhvillimeve, projekteve të ndalura në kohë për arsye madhore të cilat ndikuan jo vetëm në ekonominë e një vendi të vogël si Shqipëria, por edhe në ekonominë botërore.

Kjo periudhë e rikthimit të normalitetit përkoj edhe me prezantimin e produktit "Fast Biznes", një produkt i cili u mundëson klientëve të bëjnë realitet projektet e tyre të biznesit pa humbur kohë, pa prituri në radhë, por direkt nga biznesi i tyre, në një kohë që duket thajse e pamundur, në vetëm 15 minuta, NOA arrin të konfirmojë kredi për segmentin e biznesit, duke ritheksuar edhe njëherë vlerat e mikrofinancës, shpejtësinë, korrektësinë dhe lehtësimin në kreditim.

Për ne si Institucion mikrofinanciar, ky segment i ekonomisë ka nevojë për mbështetje dhe këshillim të vazhdueshëm, i cili gjithashtu përkon me vizionin për të mbështetur zhvillimin e ekonomive të vogla familjare duke qënë kështu një partner afatgjatë në zhvillimin e sipërmarrësve në vend.



FAMILJET & INDIVIDËT

Familjet & Individët janë një tjetër segment me rëndësi për institucionin. Financimi i këtij segmenti ka në qendër të vëmendjes familjen, duke siguruar që të mund të përmirësojnë standartet e jetesës dhe të marrin një shërbim cilësor. Gjatë 2021 ky segment siguroi një rritje prej 34% të portofolit të kredisë dhe 24% në numër klientësh, rritja më e lartë që nga lançimi i këtij produkti.

Dy vitet e fundit na mësuan, ndoshta më tepër se ç'mund të mendonim, rëndësinë e shëndetit tonë, ndaj edhe ne si NOA, kemi sjellë për klientët tanë produkte në funksion të një jete sa më të mirë.

Gjatë vitit 2021 lançuan produktin "Kredia ECO", të quajtur ndryshe "kredia e zgjuar", një formë dhe linjë financimi e cila ka në fokus rikonstruksionin, rimobilimin duke shfrytëzuar energjinë e rinovueshme. Gjithashtu për t'i ofruar më shumë mundësi për mbështetje financiare çdo individ, kemi punuar në shtimin e kanaleve alterantive për qasjen e kërkesës për këtë segment, me mundësi financimi Online përmes website të NOA, me financim në 15 minuta dhe mundësi blerje me këste të produkteve dhe shërbimeve konsumatore në çdo pikë të rrjetit të partnerëve tanë.

Investimet në këtë segment, janë realizuar për të bërë jetën e kohëve moderne në të cilat po jetojmë, sa më të thjeshtë, me akses të plotë në produkte

digjitale duke i siguruar dhe plotësuar vetes nevoja të tjera për ritmet e jetesës së ditëve të sotme.

Si NOA, vijojmë të jemi të angazhuar për të sjellë më të mirën për klientët tanë, me risi, inovacion dhe përmirësime të vazhdueshme me një shërbim 360 gradë dhe kjo falë zhvillimeve inovative të institucionit.

Edhe pse për ne, zhvillimet teknologjike e inovative kanë qënë gjithmonë në planet tona zhvillimore, duket se pandemia dhe situata post-covid i përshpejtoi për të plotësuar në këtë mënyrë nevojat e klientëve tanë gjatë 7 ditëve të javës e në çdo kohë. Nuk mjafton për një klient vetëm koha e shpejtë e realizimit të një kredie, por shërbimi pas financimit, është proces edhe më i rëndësishëm.

Të ndërgjegjshëm për këtë, kemi punuar intensivisht për të vënë në dispozicion të çdo klienti tonë "Llogaria Ime". Nga vetë fjala "Llogari", nëpërmjet regjistrimit unik të tij, klienti mund të ndërveprojë me "agjentin virtual" në NOA, duke kërkuar apo aksesuar të gjithë informacionet e nevojshme mbi financimin e tij si: këstin mujor, datën e pagesës e deri te dokumenta të ndryshme apo oferta të dedikuara.



NJË HAP PËRPARA DREJT TRANZICIONIT TEKNOLOGJIK



#ReInventingMicrofinance për NOA nuk është thjesht një moto institucionale. Është një vizion i vazhdueshëm në kërkim të përmirësimit, të shpejtësisë dhe të standarteve të reja në ofrimin e shërbimeve tona financiare. Në këtë drejtim, viti 2021 ishte një moment arritjesh për aktivitetin tonë.

Të afrojmë sa më shumë klientët me shërbimet tona; të përshpejtojmë sa më shumë kohën e financimeve; të ofrojmë një shërbim gjithmonë e më miqësor ndaj klientelës, duke ruajtur standartet më të larta të sigurisë dhe profesionalizmit, të transparencës e të minimizimit të riskut; duke përmirësuar cilësinë e punës njëherazi për klientët dhe për stafin tonë... këto janë objektivat tona në çdo investim teknologjik.

Modernizimi dhe thjeshtimi i faqes sonë Web, pasurimi i shërbimit dhe produkte të reja në tablet, investim në servera më modernë, digjitalizimi i qendrës së marrëdhënieve me klientin, përzgjedhja e stafit nëpërmjet intervistave të punës tërësisht online etj. janë të shumta risitë teknologjike në të bërit biznes

në NOA gjatë vitit 2021. Duke përqaftuar inovacionin, sfidat njerëzore e teknike, idetë dhe ambiciet e çdo njësie, arritëm gjatë vitit 2021 të mbështesim në rrafshin operacional një ndër vitet më intensive në aktivitetin institucional 24 vjeçar të kredithënies me një rritje të portofolit të kredisë krahasuar me vitin e mëparshëm prej 13%.

Sikur kjo ambicie të mos mjaftonte, tranzicioni drejt punës në distancë apo drejt një ekonomie tërësisht digjitale, ishte një ndër sfidat-risi që la pas kriza e Covid-19. Me qëllim për t'ju përgjigjur këtij standarti të ri të tregut shqiptar dhe ndërkombëtar, si NOA arritëm me sukses të projektojmë gjatë vitit 2021 një model të ri biznesi i cili garanton një proces kreditimi tërësisht në distancë. NOA gjatë 2021 konsolidoi themelet drejt një tranzicioni teknologjik të asaj çka është mikrofinanca e së ardhmes - Një mikrofinancë, gjithmonë e më afër komuniteteve të shërbyera, gjithmonë e më shumë e adaptuar ndaj nevojave të sipërmarrësve të vegjël, gjithmonë e më reflektuese ndaj pritshmërive të çdo klienti, ku(r)do.

KREDITIM & KËSHILLIM: NJË FORMULË NË SHËRBBIM TË RIMËKËMBJES

Me qëllim përshpejtimin e rimëkëmbjes ekonomike post-covid të fermerëve dhe sipërmarrësve të vegjël klientë të NOA, viti 2021 pati një rritje të aktiviteteve këshillimore të NOA. Këshillimi është një garanci shtesë që kreditë e ofruara të mos mbeten vetëm në rrafshin financiar, por të zgjerohen dhe në rrafshin teknik. Kombinimi mes financimit dhe këshillimit sjell rritjen e impaktit në punësim, uljen e rreziqeve të investimit dhe mundësitë për një ekonomi shkalle të ardhshme. Si rezultat, gjatë vitit 2021, përpos këshillimeve mbi impaktin e fiskalizimit për bizneset e vogla,

janë mbi 30 skeda agro-teknike që u janë ofruar falas klientëve ruralë të NOA-s si një mënyrë mbështetjeje të prodhimit të tyre. Skedat janë redaktuar dhe shpërndarë nëpërmjet kanaleve të komunikimit digjitale të NOA-s sipas kalendarëve, karakteristikave gjeografike dhe kërkesave specifike të tregut duke u siguruar gjithmonë që informacioni jepet aty ku ka realisht impakt. Ato prekin bletarinë, blegtorinë, pemtarinë dhe teknika specifike me ndikim në rritjen e prodhimtarisë dhe të të ardhurave të klientëve të NOA-s.



Këshillimi është tanimë një realitet i konsoliduar në Institucionin tonë. Krahas redaktimit dhe shpërndarjes së shënjestruar të agro-skedave sipas specifikave individuale të klientëve tanë, stafi ynë ka organizuar mbi 15 seminare e trajnime me ekspertë të ekonomisë rurale e prodhimit bujqësor. Këto aktivitete janë ofruar falas drejt banorëve të zonave rurale dhe kanë patur një shtrirje kombëtare. Qëllimi ynë ishte promovimi i praktikave më të mira prodhuese e të bërit biznes në një mjedis agro-rural duke pasur parasysh sfidat e mëdha të këtyre territoreve në një kontekst post-covid dhe migrimi demografik.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve këshillimore, NOA kërkon të nxisë një edukatë financiare e cila kombinon kredimarrjen me këshillimin teknik, me qëllim rritjen e impaktit në krijimin e vendeve të reja të punës, praktikave të reja të të bërit biznes, promovimin e teknologjive të reja miqësore ndaj mjedisit, si dhe impaktin pozitiv social të lidhura me to. Duke kombinuar mikro-financimet me një këshillim të përshtatur, NOA beson se ofron një garanci shtesë në arritjen e objektivit të saj socio-ekonomik dhe të një modeli të qëndrueshëm të një institucioni financiar të përgjegjshëm.

KOMUNIKIMI, NXITËS I NJË IMPAKTI SOCIAL MË EFEKTIV

Si të sigurohemi që financimet tona gjenerojnë maksimumin e të ardhurave për përfituesit e tyre? Si të sigurohemi që klientët tanë marrin një shërbim brenda nevojave dhe karakteristikave të profileve të tyre individuale? Si të sigurohemi që klientët tanë janë të ndërgjegjshëm për mbi-kreditimin? Por mbi të gjitha, çfarë e bën një institucion kredidhënës të jetë më pranë klientëve të saj kundrejt një institucioni tjetër?

Sfida e rimëkëmbjes ekonomike post covid-19 gjatë vitit 2021, parashtrroi pyetje të reja mbi mënyrën sesi mund të rrisim impaktin tonë në të përditshmen e klientëve tanë. Duhet të bënim më shumë për të lehtësuar rimëkëmbjen, më

shumë për të mbrojtur vendet e punës dhe aktivitetin e sipërmarrësve të vegjël, të fermerëve dhe të familjeve vulnerabël. Përgjigja nuk ishte dhe aq e vështirë për ekipin tonë. U fokusuam për të bërë dhe më mirë atë që është dhe avantazhi ynë krahasues kryesor : komunikimi, i cili për Institucionin tonë, nënkupton:

të dëgjosh dhe të ofrosh produkte që pasqyrojnë nevojat reale në terren; të dialogosh me transparencë duke adresuar çdo paqartësi; të angazhohesh për të ofruar të njëjtin standart unik, kudo & kurdo. të mirëkuptosh problematikat dhe të gjes zgjidhjen e duhur për klientët në vështirësi.



EKSPERIENCA E KLIENTIT, NJË INVESTIM I VAZHDUESHËM NË PËRMIRËSIM


Për herë të parë, klientëve ju mundësua gjatë vitit 2021 ofrimi 100% i të gjithë procesit të kredihënies në terren, duke ulur afër zeros kostot e aksesimit në financim. Kjo u arrit falë kombinimit të zgjidhjeve teknologjike të avancuara mobile me ato biometrike të ofruara nga ALEAT. Ky është një shembull real sesi komunikimi mes klientit dhe oficerit të kredisë mund të arrijë nivele efikasiteti ende të paprovuara më parë.

Po kështu për herë të parë, klientëve tanë, ju mundësua një centralizim i kanaleve të komunikimit brenda një platforme unike e cila rrit shpejtësinë dhe cilësinë e trajtimit të çdo kërkesë. Në një kontekst post-covid, ofrimi i një komunikimi distant elektronik në real-time, është një standart i ri i paevitueshëm. Kjo e lehtëson

klentit në aksesimin e shërbimeve financiare por njëkohësisht rrit transparencën në adresimin e çdo paqartësie. Krijimi i një faqe të re Web gjatë 2021 i shërben po këtij objektivi.

Gjithmonë në drejtim të komunikimit, rritëm intensitetin e shkëmbimeve në drejtim të klientelës sonë duke ofruar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh "këshillimore", me rreth 21,000 komunikime mesatare në muaj nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit, si, WhatsApp, Telefoni dhe Media Sociale. Kjo përkthehet në një marrëdhënie edhe më cilësore me përfituesit tanë, duke u siguruar gjithmonë e më shumë që financimet shoqërohen nga ide, plane e zbatime konkrete që sjellin zhvillim, standarte të reja e përfitim për mbarë shoqërinë.

KOMUNIKIMI SIPAS KANALEVE



Në NOA ne vlerësojmë ndërtimin e një komunikimi njerëzor por dhe teknologjik, gjithmonë në shërbim të të njejtit mision social si para 24 vitesh. Ky ka qënë dhe fokusi i fushatave të komunikimit "Borrow Wisely" apo të daljeve të shpeshta mediatike gjatë viti 2021 gjithmonë me qëllim ndërgjegjësimin e komuniteteve që shërbejmë mbi risqet e mbi-kreditimit, mbi

risitë e kreditimit on-line, mbi oportunitetet që rezultojnë nga kombinimi i granteve publike me linjat tona të financimit, mbi muajin e auditimit apo dhe pritshëritë e sektorëve kyç. Si në media apo në rrjete sociale, në NOA ne jemi tërësisht të angazhuar në komunikimin e #ReInventingMicrofinance.



NJË PASQYRË RISISH

#Fast Business dhe #Partnership

E gjithë shoqëria është ndikuar prej ndryshimeve të forta që imponoi COVID-19. Janë pikërisht këto kohë të vështira që i shtynë njerëzit të gjejnë mënyra të reja për t'u përballur me realitetin e ri si dhe gjetjen e shumë zgjidhjeve novatore.

Kjo periudhë, me sfidat e reja të saj, ka qënë një nxitje në përdorimin e zgjidhjeve të Teknologjisë së Informacionit edhe në sektorë të ekonomisë që më parë kishin një përdorim të moderuar.

Në këtë aspekt, NOA mbetet një pionier në drejtimin e operacioneve të biznesit mbështetur në zgjidhje të avancuara të Teknologjisë së Informacionit për të përmbushur më mirë kërkesat dhe pritshmëritë e klientëve. Duke pasur parasysh që institucioni ofron shërbime për një gamë të gjerë klientësh, përqaftimi i teknologjive të reja do të vijojë të jetë synimi ynë afatgjatë për të ofruar zgjidhje bashkëkohore biznesi në funksion të efikasitetit dhe shërbimit të shpejtë ndaj klientit.

Dy nga risitë më të rëndësishme përgjatë vitit 2021, kanë qënë ofrimi i produkteve të shpejta për biznesin micro "Fast Business" dhe shërbimi i "Partneriteteve", duke i dhënë rëndësinë e duhur secilit prej tyre. "Fast Business" është krijuar si rezultat i filozofisë sonë, një kompani që kërkon gjithmonë të ofrojë shërbimin më të shpejtë për klientin nën një vizion të qartë dixhital për të ardhmen; një financim i shpejtë në 15 min për çdo biznes mikro. Shërbimi i Partneriteteve është një nga risitë më të rëndësishme tonat në treg, duke lehtësuar aksesin për produkte dhe shërbime në rrjetin e klientëve tanë dhe jo vetëm, duke përfshirë edhe aksesin në tregje ndërkombëtare. Përqaftimi i kësaj mënyre të re të të menduarit ka bërë që zhvillimet teknologjike të pranohen lehtësisht prej stafit dhe klientëve tanë, si një ndryshim pozitiv në shërbimin e punës sonë të përditshme, me zhvillime teknologjike të integruara dhe përshtatura me produkte të reja.

SIGURIA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE, BESUESHMËRISË DHE FLEKSIBILITETIT TË SISTEMEVE IT

Besueshmëria dhe qëndrueshmëria janë faktor kyç në rritjen dhe stabilitetin e biznesit në të ardhmen, të cilat si institucion i sigurojmë nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës IT. Me zhvillimin dhe rritjen e institucionit, por edhe për të qënë në një linjë me kohën në të cilën jetojmë, është jetike rritja dhe zhvillimi i sistemeve IT, krijimi i infrastukturave plotësisht të virtualizuara të serverave të cilët të kombinuar të gjithë së bashku mundësojnë një mirëfunksionim të optimizuar të sistemeve të biznesit. Në këtë aspekt, një fokus kryesor për vitin ishte gjithashtu përmirësimi dhe krijimi i sistemeve të rikuperimit dhe vazhdueshmërisë për të krijuar një nivel të lartë sigurie.

Siguria në internet është bërë një çështje shumë e ndjeshme dhe sensitive për të gjitha kompanitë. Në këto kohë çdo kompani është duke gjetur alternativa të reja të të bërit biznes online edhe pse niveli i ekspozimit dhe riskut është gjithashtu i lartë. Ndërgjegjësimi ndaj situatës, investimi në sisteme me siguri të lartë si dhe gjetja e mënyrave të duhura të mitigimit të riskut në nivelet maksimale, janë kthyer në një prioritet të përditshëm.

NDËRVEPRIMI DHE PËRMIRËSIMI I PROÇESEVE

Në NOA ne angazhohemi për të krijuar një marrëdhënie afatgjatë me klientët dhe partnerët tanë të biznesit. Një marrëdhënie e tillë bashkëpunimi na lejon të krijojmë një rritje dhe zhvillim biznesi të suksesshëm në mënyrë të dyanëshme, duke krijuar kështu edhe impaktin tonë në ekonomi. Gjatë vitit 2021, kemi vlerësuar si një zgjidhje të suksesshme ndërtimin e një bashkëpunimi i cili na krijon lehtësinë e komunikimit dhe ofrimit të shërbimit të pagesave të klienteve në kohë reale. Kjo marrëveshje ka ndihmuar për të ofruar shërbim me një mbulim të gjerë në të gjithë

territorin e Shqipërisë, me rreth 1000 pika ofrim shërbimi.

Shpejt dhe lehtë mbetet një nga veçoritë tona si mikrofinancë duke krijuar një avantazh konkures ndaj tregut. Shpejtësia me të cilën punojmë na lejon ti ofrojmë klientëve tanë në kohën e duhur për ta, shërbimet e nevojshme, shumë shpejtë dhe thjeshtë, duke ofruar shërbimin direkt nga ambienti i biznesit me proçese të thjeshtëzuara. Për ne është kënaqësi të ndajmë rezultate shumë të mira në kohën e proçesimit të një kredie në NOA:



Koha e proçesimit mesatar: 5.8 orë pune


PRAKTIKAT MË TË MIRA NDËRKOMBËTARE, JANË DHE LOKALE

Krijuar fillimisht nga USAID, për t'u zhvilluar më tej si një investim me kapital privat të huaj 100%, NOA ka qënë gjithmonë paravijë në promovimin e praktikave më të mira të kreditimit në Shqipëri. Hapja ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar është ende sot e kësaj dite një ndër karakteristikat që e veçon NOA-n nga institucionet e tjera mikrofinanciare.


Gjatë vitit 2021 janë disa nismat të cilat u mundësuan falë përfshirjes së NOA-s në nisma

të karakterit ndërkombëtar. Në këtë drejtim, vlen të theksohet pikësëpari se janë mbi 7 Milion Euro të disbursuar nga 5 partnerë ndërkombëtarë të cilët i mundësuan NOA-s të mbështesnin aktivitetin e saj në shërbim të rimëkëmbjes ekonomike post krizës covid-19. Këto janë linja financimi ndërkombëtare private tërësisht të pavarura nga projekte apo iniciativa donatorësh dhe që nuk do të injektoheshin në ekonominë shqiptare pa rolin ndërmjetësues të Institucionit tonë.

Struktura e borxhit sipas monedhës nga Investitorë të huaj



Struktura e borxhit sipas origjinës



Një nismë e veçantë realizuar gjatë vitit 2021 ishte dhe bashkëpunimi i NOA-s me EMN (European Microfinance Network) dhe MFC (Microfinance Center), dy organizatat lider të mikrofinancës në kontinentin europian. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, NOA kontribuoi në redaktimin e një "Policy Paper" mbi impaktet që ka në Shqipëri dhe në Europën lindore emigrimi masiv i të rinjve dhe shpopullimi në përgjithësi. Dokumenti ka si qëllim ndërgjegjësimin e aktorëve institucionale europianë në trajtimin e kësaj sfide me impakt shumë të lartë social dhe ekonomik për komunitetet dhe territoret më të varfëra e të përjashtuara, si Shqipëria.

Në këtë kontekst, gjatë vitit 2021, NOA, mbështetur nga Bashkimi Europian dhe EMN, organizoi një udhëtim biznesi/studimor në Itali mbi mënyrat sesi mund të ofrohen financime të përshtatura për komunitetet shqiptare që jetojnë mes dy vendeve dhe kërkojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre ekonomik në Shqipëri. Udhëtimi ishte një mundësi e mirë për të përforcuar marrëdhëniet Institucionale me partnerët italianë dhe për të zgjeruar dhe gamën e produkteve financiare që institucioni mund të ofrojë në të ardhmen. Një vizitë studimore e ngjashme u organizua dhe në Francë (Paris), në partneritet me institucionin mikrofinanciar europian Adie, në muajin nëntor 2021.

NOA mori pjesë gjithashtu në edicionin e 23-të të Forumit Europian të Mikrofinancës, i pari plotësisht digjital, ku prezantoi risitë teknologjike, rezultatet financiare pozitive dhe fushatat e komunikimit të zhvilluara gjatë periudhës post-covid. NOA u identifikua si një ndër institucionet financiare më proaktive dhe mbështetëse të praktikave inovative dhe sociale. Po në këtë drejtim, organizuam në tetor të vitit 2021 promovimin e Ditës Europiane të Mikrofinancës si një mënyrë për të identifikuar e promovuar praktika të reja financiare që e afrojnë gjithmonë e më shumë aksesin në financë, me komunitetet e shërbyera nga stafet tona.

Një risi dhe për vetë stafin tonë, gjatë verës së vitit 2021, NOA priti një grup studentësh francezë nga EM Lyon në kuadër të një projekt studimi të ndërmarrë mbi të ardhmen e mikrofinancës. Studentët francezë u sfiduan dhe kontribuan me ide se si e ardhmja mund t'i shtojë vlerë sloganit tonë institucional #ReInventingMicrofinance. Me një moshë mesatare të stafit prej 35 vjeç, jemi një institucion i cili promovon fuqimisht të rinjtë dhe inovacionin jo vetëm në aspektin e karrierës apo të teknologjive të reja që ata përdorin, por dhe në drejtim të kontributit me ide që të rinjtë kanë, të pritshmërive të tyre nga shoqëria dhe ekonomia kombëtare e ajo europiane drejt të cilës aspiron vendi ynë.

NJË INSTITUCION NË TERREN, KU(R)DO

Gjatë vitit 2021, janë 10,723 kredi të disbursuara për një volum prej 4,435 miliard lekësh. Ishte një vit që e gjeti stafin tonë edhe më shumë në terren se zakonisht si një mënyrë e drejtëpërdrejtë për të ndihmuar rimëkëmbjen ekonomike post-covid. Nëpërmjet një përdorimi intensiv të tabletave mobile biometrike, automjeteve dhe prezencës në terren, qëllimi ynë ka qënë të ulim kostot maksimalisht për përfituesit e financimeve tona duke u siguruar që jemi pranë tyre në çdo fshat, ambient biznesi,

komunitet e në çdo fazë të planit të investimeve të tyre. Jo më kot, fushata marketing e vitit 2021 ishte me mesazhit "Ku(r)do", si një konfirmim që nëpërmjet nesh, aksesit në financë nuk ka qënë kurrë më i përshtatur. Një objektiv që arrihet duke u siguruar gjithashtu që klientët tanë të aplikojnë në kanale të ndryshme qoftë fizikisht, nëpërmjet rrjetit të degëve tona anembanë vendit, ashtu dhe online apo nëpërmjet telefonisë dhe qendrës tonë të shërbimit ndaj klientit.

Ishin lidhja me terrenin dhe komunitetet e shërbyera, që na nxitën të kontribuojmë gjatë vitit 2021 dhe në disa nisma alternativa jashtë fokusit ekonomik të përhershëm. Një ndër këto nisma, ishte bashkëpunimi me Eipass Albania duke mbështetur 30 fëmijë me aftësi ndryshe.



Një tjetër nismë gjatë vitit 2021 ishte dhe "Trees for Lurë" e cila kishte si fokus ri-pyllëzimin e një ndër territoreve më të bukura të vendit por të dëmtuar ndër vite.

Promovimi i turizmit rural ishte një mundësi e mirë për të mbështetur dhe sektorin në tërësi duke nxitur rikthimin në nivelet para krizës Covid-19. Duke mbështetur festën e "Verës & Gështenjave" në Pogradec, konfirmuam edhe njëherë gadishmërinë për të mbetur një lider i financimit të ekonomisë rurale.

"Çmimi i Impakti Social" është kthyer në një traditë tanimë në punën tonë, duke identifikuar dhe këtë vit sipërmarrësit të cilët nëpërmjet financimit të tyre, impaktuan më së shumti komunitetet e tyre lokale nëpërmjet ruajtjes së vendeve të punës, promovimit të vlerave të punës e tregut të lirë, të integritit të të rinjve dhe të grave etj.

Ne në NOA, besojmë fort se financimi i përgjegjshëm dhe përgjegjshmëria sociale mbron klientët, bizneset dhe industrinë si një e tërë. Për këtë qëllim, ne kujdesemi të jemi financues të përgjegjshëm dhe transparent; të edukojmë dhe ndërgjegjësojmë klientët tanë; të punojmë me standarde të larta etike; si edhe të ofrojmë përherë një mënyrë për të adresuar ankesat e përfituesëve të shërbimeve tona.

Për Ne, përgjegjësia sociale nënkupton adoptimin e praktikave më të mira të të bërit biznes dhe nxitjen e një impakti pozitiv të përgjithshëm në shoqëri, duke promovuar aktivitetet e Përgjegjësisë Sociale në NOA dhe duke forcuar lidhjet që kemi me klientët tanë.

Këto histori të bukura suksesi, na frymëzojnë për ta zgjeruar edhe më tej misionin tonë në identifikimin dhe mbështetjen e biznesit të vogël, rural, sipërmarrjen familjare, gratë, të rinjtë, grupet e marginalizuara, emigrantët etj.



Zj. Denada Shtylla, Agrikulturë
(produktet bujqësore eksportohen 100% në Danimarkë)



Z. Krenar Mecani, Agrikulturë
(përpunimi i ullirit)



Z. Ermir Avdoli, Shërbimi i internetit
me fibra optike



Zj. Valentina Baxheli, Hoteleri Turizëm




NJË MBËSHTETJE FINANCIARE ME RISK TË KONTROLLUAR

Në vazhdojmë të jemi krenar për modelin tonë të biznesit përse i përket riskut të kredisë, ku përmes punës së përkushtuar të stafit, ekspertizës në evidentimin e risqeve të kredisë arrijmë të kemi një efikasitet të shtuar, përgjigje në kohë reale të kërkesave të biznesit dhe një kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së portofolit të kredisë. Teknologjia dhe sistemet tona të monitorimit na mundësojnë që të vlerësojmë në një kohë të shkurtër dhe reale çdo kërkesë për kredi.

Me një staf të talentuar dhe me eksperiencë të gjatë në këtë fushë, të përkushtuar në monitorimin e cilësisë së portofolit, një sistem të automatizuar pikëzimi dhe raporte në kohë reale, kemi arritur sërish në vitin 2021 rezultate shumë të mira përse i përket ruajtjes së cilësisë së portofolit.

CILËSIA E PORTOFOLIT




PAR 30+ = 3.46%

PAR 90+ = 2.23%

w/off ratio (vjetor) = 3.9%

Recovery of w/off Ratio* = 69 %



Në drejtim të përputhshmërisë, jemi kujdesur të zbatojmë dhe përshtasim në kohë të gjitha ndryshimet ligjore të ndodhura gjatë vitit 2021, ku në veçanti vlen të përmendim masat rregullative të vazhdueshme që lidhen me transparencën ndaj klientit, që përbën një çështje thelbësore në NOA. Po kështu si çdo vit i është kushtuar një vëmendje e veçantë parandalimit të mashtrimit dhe krimit financiar nëpërmjet trajnimeve dhe vigjilencës së shtuar, seminareve dhe bisedave të shpeshta me stafin tonë, duke siguruar një përputhje të plotë me kërkesat rregullatore në fuqi.

Në kuadër të ruajtjes së standarteve të kredihënies realizohet një proces monitorimi i detajuar duke kryer një kontroll në terren i kredive të disbursuara në masën 40% të numrit total të disbursimeve të kryera.


Një ndihmesë e rëndësishme, me qëllim përmbushjen e kërkesave të përputhshmërisë, ka qënë edhe përdorimi i teknikave automatike dhe gjysëm automatike si dhe teknologjisë fintech prandaj NOA i kushton një vëmendje të veçantë zhvillimit të teknologjisë.

BURIMET NJERËZORE, VLERA E VERTETË E NJË KOMPANIE

Viti 2021 për burimet njerëzore shënoi një nivel edhe më të lartë të fokusimit në shëndetin dhe mirëqënien e stafit, ndërtimin e ekipeve, mbledhjet, trajnimet në nivel degësh, rajoni dhe kompanie.

Për të përmbushur misionin tonë, përgjatë këtij viti na u bashkuan 83 staf, prej të cilëve 85% në nivel rrjeti degësh, të cilët nëpërmjet energjisë, dinamizimit, vlerave që ata përfaqësojnë së bashku me skuadrat që i mirëpritën, impaktuan në rritjen e aksesit në financë për familjet dhe sipërmarrësit e vegjël në Shqipëri.

Nga ana tjetër NE vazhdojmë të investojmë gjithnjë e më shumë në diversitet dhe mundësi të barabarta, duke patur një kompozim unik të stafit prej 280 veta, me një moshë mesatare 35 vjeç.



Viti 2021 shënoi gjithashtu një rritje mahnitëse prej 15% të qëndrueshmërisë dhe angazhimit të stafit, falë dedikimit të NOA për të përmbushur standartet më të larta të trajtimit, mirëqenies dhe rritjes së kënaqësisë në punë të stafit.

Me fokus zhvillimin e njerëzve dhe motivimin sepse ne besojmë që kjo është kyç për zhvillimin e kompanisë, pavarësisht kufizimeve, arritëm të ofronim 610 orë trajnimi sikurse realizuam 11 promovime të brendshme, prej të cilave 5 në nivel manaxherial.

Për të celebruar arritjet e gjashtë mujorit të parë të vitit 2021 dhe për t'u energjizuar dhe siguruar që së bashku jemi gjithnjë e më të fortë për pjesën tjetër, organizuam një aktivitet me të gjithë stafin përgjatë verës.

Ne do vijojmë të përmbushim misionin tonë për të ndërtuar burime njerëzore të angazhuara dhe të motivuara, të gatshme për të ecur drejt vizionit dixhital të NOA, por të përkushtuar fuqishëm ndaj Misionit, Vizionit dhe Vlerave Tona.

KONTROLL I VAZHDUESHËM PËR NJË SHËRBIM TEPËR CILËSOR




Gjatë vitit 2021, një fokus i veçantë i funksionit të auditorit të brendshëm ka qënë ndjekja periodike e aktivitetit të klientëve të institucionit, jo vetëm nëpërmjet analizave të treguesve të tyre financiar, por edhe vizitave dhe takimeve direkte me ta. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për takimet me drejtuesit e degëve të institucionit jo domosdoshmërisht si pjesë e planit të auditimit, por më shumë si pjesë e një praktike tashmë të konsoliduar në NOA për të ruajtur një kontakt të vazhdueshëm në të gjitha nivelet manaxheriale, përfshirë dhe drejtuesit e kontrollit të brendshëm.

Si çdo vit, kjo na ka ndihmuar në një njohje më të mirë të institucionit në tërësinë e vet, duke siguruar një garanci më shumë për ecurinë dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të brendshme në nivel qendror dhe rajonal.

Kontaktet me manaxhimin kanë qënë gjithashtu në fokus të punës së funksionit të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet komunikimit të gjetjeve shoqëruar me rekomandime si

dhe në ndjekjen e tyre në vazhdimësi duke mundësuar një kohezion të përbashkët që e ndihmon klimën e bashkëpunimit në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit të kontrollit të brendshëm. Përgjatë vitit 2021, kemi realizuar 59% auditim të rrjetit të degëve dhe 5% të njësive në zyrat qendrore. Ndërkohë që nga rekomandimet vjetore, është konstatuar se 64% e tyre janë zbatuar tashmë, ndërkohë 36% janë në proces. Fokusi ynë kryesor në kontrole të shpeshta, në degë apo edhe në departamentet/njësitet në zyrat qendrore, vjen si rezultat i vizionit tonë si institucion për të ofruar më të mirën për çdo klient të cilit i shërbejmë.

Si rezultat i punës së auditimit të brendshëm në bashkëpunim me drejtuesit e institucionit, themi me bindje se ambjenti i kontrolleve të brendshme në NOA paraqitet sot i maturuar më së miri si një shembull i praktikave më të mira në tregun e institucioneve mikrofinanciare.



AUDIT REPORT



Grant Thornton Shpk
Rr. Sami Frasheri , Kompleksi T.I.D
Hyrya B, Kati 1
1000 Tirana
Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e NOA Sh.a,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NOA Sh.a. (këtu e më poshtë referuar “Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabel dhe të tjera shënime shpjeguese. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabel të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdoje Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrave financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizem profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marreveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabel të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabel dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabel të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, në duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

30 mars 2022



Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Shumat në mijë lekë)

Aktivitet	Shënime	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	16	451,896	354,295
Hua institucioneve financiare	17	167,175	338,167
Hua dhe paradhënie klientëve, neto	18	5,751,651	5,082,474
Inventari dhe aktive të tjera	21	66,530	46,887
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi	19	191,426	182,873
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	20	26,140	23,973
Aktive të shtyra tatimore	15	20,705	23,003
Totali i aktiveve		6,675,523	6,051,672
Detyrimet dhe kapitali Detyrimet			
Detyrimet			
Tatim fitimi i pagueshëm	15	6,571	7,521
Detyrime të tjera	23	231,837	238,192
Hua	22	4,561,472	4,252,620
Totali i detyrimeve		4,799,880	4,498,333
Kapitali			
Kapitali i paguar	24	731,838	731,838
Rezerva ligjore	25	64,027	50,067
Fitime të mbartura		1,079,778	771,434
Totali i kapitalit		1,875,643	1,553,339
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		6,675,523	6,051,672



Komuna e Parisit, rr. "Tish Daia"
Kompleksi "Haxhiu", ND.32, H. 12,
Tiranë, Shqipëri



+355 68 40 01 403



www.noafin.al



info@noafin.al